



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 389 / prot.
3

Pogradec, më 19.09, 2024

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Z. MANJOLA KAMOLLI
KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:
"PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, PËR NDERTIM PARK FOTOVOLTAIK (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET PERKATESE), NË PASURITE ME SIPËRFAQE TOTALE 47.4663 (DYZËT E SHTATE PRESJE KATERMIJE E GJASHTEQIND E GJASHTEDHJETE E TRE) HA".

Me respekt,



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (Dy)
Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (Dy)
Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 10(Dhjete)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____ 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, DATË ____ / ____ /2024

PËR

**MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, PËR NDERTIM
PARK FOTOVOLTAIK (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET
PERKATESE), NË PASURITE ME SIPËRFAQE TOTALE 47.4663 (DYZET
E SHTATE PRESJE KATERMIJE E GJASHTEQIND E
GJASHTEDHJETE E TRE) HA.**

Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", të ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ", të ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 559, datë 29.7.2022 "Per percaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish-komunave /Bashkive", te ndryshuar me vendimin nr 398 date 13.05.2020, Udhezimit Nr.13, datë 26.04.2018 "Per zbatimin e vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfitcoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1.Të miratojë në parim dhënien në përdorim, për ndërtim park fotovoltaik (stacionet, bazamentet dhe objektet perkatese), në pasuritë e ndodhura në fshatin Homezh Njësinë Administrative Proptisht, fshatin Udenisht Njësinë Administrative Udenisht Bashkia Pogradec, me të dhënat si më poshtë:

Nr	Z.K	Nr Pasur	Vëndodhja	Siperf në m2	Objekti kerkeses
1	1959	486	Homezh, Proptisht	230788	Park Fotovoltaik
2	3665	811	Udënisht, Udënisht	243875	Park Fotovoltaik
			SHUMA	474663	

2. Afati i dhënies me qera të jetë deri në 10 vite, me të drejte ripertëritje, sipas periudhes të percaktuar në projekt, dhe studimin e fizibilitetit të dorëzuar nga kërkuesit në konkurim.
2. Ky proces të kryhet sipas percaktimeve të Vendimit Nr. 54, datë 05.02.2014 të Keshillit të Ministrave "Për percaktimin e kritereve, të procedurës dhe të menyrës së dhënies me qira, enfitoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.
3. Tarifat për dhënie në përdorim/qera të këtyre pasurive, të aplikohen sipas pika 8 e shtojcës nr 1 të Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 559, datë 29.7.2022 "Për percaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".
4. Shoqëritë kërkuese të përdorin pasuritë e mësipërme për ushtrimin e aktivitetit të saj sipas objektivit të parashikuar në kërkesën e tyre dhe studimin e fizibilitetit të paraqitur për marrjen në përdorim të pasurive.
5. Të Autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec për lidhjen e kontratës, mbas përfundimit të procedurave konkurruese.
6. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë Pogradec.
7. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

**KRYETAR
MANJOLA KAMOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI



Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____ 2024

RELACION

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, PËR
NDERTIM PARK FOTOVOLTAIK (STACIONET, BAZAMENTET DHE
OBJEKTET PERKATESE), NË PASURITE ME SIPËRFAQE TOTALE
47.4663 (DYZET E SHTATE PRESJE KATERMIJE E GJASHTEQIND E
GJASHTEDHJETE E TRE) HA.**

INDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT ! TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Bashkia Pogradec në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, referuar pikës 2 të nenit 27 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ndër të cilat është edhe Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme pyje etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, posacerisht të kaluara në pronësi të saj me Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish-komunave /Bashkive", te ndryshuar me vendimin nr 398 date 13.05.2020Me transferimin e pronave në administrimin vendor, menaxhimi i aseteve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin. Për sa më sipër, Sektori i verifikimit të titujve të pronësive, Bashkia Pogradec, ka marrë në shqyrtim mundësinë dhe pronat që mund të perdoren për ndertimin dhe zhvillimin e energjise se rinovueshme dhe prodhimit të saj nga dielli, sektori perkates evidentoi pasurite qe ndodhen ne pjese te dukshme dhe qe jane shume te mira per zhvillimin e ketij procesi ne fushën e energjisë së rinovueshme.

Gjate shqyrtimit edhe verifikimi i statusit të pronësive, të pasurive objekt ketij projektvendimi dhe rezultoi si me poshtë:

1.- Pasuria 486 ne zonen kadastrale 1959 Fshati Homezh me siperfaqe 230788 m2 shtrihet ne nje toke pyjore kullote te abandonuar dhe demtuar si nga erozioni dhe faktore te tjere atmosferike, kjo siperfaqe nuk eshte e punuar dhe perdorur qe nga vitet 90 afer 30 vjet, nuk posedohet apo zoterohet nga asnje individ ne fshat apo tjetër kund, kete e vertetoj edhe keqyrja ne vend e saj dhe certifikata e pronësise ne emer te Bashkise Pogradec.

2.- Pasuria 811 ne zonen kadastrale 3665 Fshati Udenisht me siperfaqe 243875 m2 shtrihet ne nje toke pyjore kullote te abandonuar dhe demtuar si nga erozioni dhe faktore te tjere atmosferike, kjo siperfaqe nuk eshte e punuar dhe perdorur qe nga vitet 90 afer 30 vjet, nuk posedohet apo zoterohet nga asnje individ ne fshat apo tjetër kund, kete e vertetoj edhe keqyrja ne vend e saj dhe certifikata e pronësise ne emer te Bashkise Pogradec.

Per sa me siper, si dhe para se të dorëzohej projekt vendimi ne Keshill, u mbajt korespondenca me ASHK Drejtoria Vendore Pogradec dhe jemi paisur me certifikaten e pronësise per kete pasuri, Ne keto kushte, në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", të ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Kreun VI të

Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave /Bashkive", të ndryshuar me vendimin nr 398 date 13.05.2020, Udhëzimit Nr.13, datë 26.04.2018 "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitheoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë në parim dhënie në përdorim, me konkurim në favor të shoqërive kërkuese, me kontratë qeraje me afat deri në 10 vite, me të drejtë ripertëritje sipas periudhës të përcaktuar në projekt dhe studimit të fizibilitetit që do dorëzohen nga kërkuesit, për ngritje parku fotovoltaiq, me klauzole në kontratë që neqoftese nuk realizohet ndërtimi i parqeve sipas lejes së Ministrisë përkatëse, vitin tjetër mbas mbarimit të lejes prona kalon në administrim të Bashkisë Pogradec dhe kontrata quhet e prishur. Miratimin e dhënies me qira për pasurinë e ndodhura në fshatin Homezh Njësinë Administrative Proptisht, fshatin Udenisht Njësinë Administrative Udenisht Bashkia Pogradec, me të dhënat si më poshtë:

Nr	Z.K	Nr Pasur	Vëndodhja	Siperf në m2	Objekti kerkeses
1	1959	486	Homezh, Proptisht	230788	Park Fotovoltaiq
2	3665	811	Udënisht, Udënisht	243875	Park Fotovoltaiq
			SHUMA	474663	

Në referim të bazës ligjore të sipërcituar, ky proces të kryhet sipas përcaktimeve të Vendimit Nr. 54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitheoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.

Tarifat për dhënie në përdorim/qera të katër pasurive, të aplikohen sipas pikës 8 e shtojcës nr 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".

Gjithashtu, kontrata bashkëngjitur projekt vendimit, është hartuar në zbatim të Vendimit Nr. 421, datë 12.6.2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitheozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.

Përfundimisht, për sa me sipër, në zbatim të nenit 54, shkronja "e" të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2014 "Për vetëqeverisjen vendore", citohet se: "**Këshilli bashkiak, ndër të tjera, e) miraton tjetërsimin ose dhënie në përdorim të pronave të tretëve**".

Duke pasur besim të plotë, ju ftojme të miratoni projekt vendimin e paraqitur.

Ju falënderit!

Konceptoi Nexhmi TORRA

Miratoi Johan STERJO

Konfirmoi Dritan BABASULA

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**



KONTRATË QERAJE

Sot më datë __. __. 2024, në ambjentet e Bashkisë Pogradec, me vullnet të lirë midis palëve lidhet kjo kontratë me përmbajtje dhe me palë si më poshtë vijon:

1. Bashkia Pogradec, me adresë: Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com, përfaqësuar nga Kryetari **Hir XHAKOLLI**, madhor me zotësi juridike për të vepruar, që më poshtë do të quhet "**QIRADHËNËSI**"

&

2. **Subjekti** " _____ ", përfaqësuar nga _____ i datëlindjes _____, lindur në _____ dhe banues në _____, me shtetësi Shqiptare, identifikuar me letër njohimi personal me nr. _____, që më poshtë do të quhet "**QIRAMARRËSI**".

Palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

NENI 1 BAZA LIGJORE

- 1.1 Ligji Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.
- 1.2 Nenet 784 - 825 të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- 1.3 Ligji Nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar.
- 1.4 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore".
- 1.5 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave /Bashkive", të ndryshuar me vendimin nr 398 date 13.05.2020
- 1.6 Udhëzimi Nr. 13, datë 26.4.2018, "Për zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar.
- 1.7 Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhenien në përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore"
- 1.8 Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë.

NENI 2 KOHËZGJATJA

2.1 Kjo kontratë është e vlefshme për 10 (Dhjetë) vite, me të drejtë ripërtëritje sipas periudhës të përcaktuar në projekt dhe studimit të fizibilitetit të hartuar nga kërkuesit, për ngritje parqesh fotovoltaike.

2.2 Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

NENI 3 QËLLIMI I PËRDORIMIT



3.1 Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia me qera e sipërfaqes () Ha, për ngritjen park fotovoltaiik, në pasuritë e mëposhtme:

Nr	Z.K	Nr Pasur	Vëndodhja	Siperf në m2	Objekti kerkeses
1					
2					

NENI 4 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

4.1 "Qiradhënësi", si njësi që ka në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e "Qiramarrësit".

4.3 "Qiradhënësi" ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës së qirasë, Sektorit të Monitorimit të Kontratave, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.4 "Qiradhënësi" është i detyruar të garantojë "Qiramarrësin" për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.5 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.6 "Qiradhënësi" nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

NENI 5 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

5.1 "Qiramarrësi" ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 "Qiramarrësi" ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 4, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar.

5.3 "Qiramarrësi" detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në plan biznesin e paraqitur në komisionin e vlerësimit të dokumenteve.

5.4 "Qiramarrësi" detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

5.5 "Qiramarrësi" detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

5.6 "Qiramarrësi" detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.

5.7 "Qiramarrësi" detyrohet të paguajë detyrimin mujor të qirasë brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë. Për çdo ditë vonesë, do të paguajë një kamatë ditore prej 0.1% të vlerës së qirasë mujore.

5.8 "Qiramarrësi" detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.9 "Qiramarrësi", në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa e dëmtuar atë. "Qiradhënësi" nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga "Qiramarrësi".

5.10 Në ngarkim të "Qiramarrësit" janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

5.12 "Qiramarrësi" në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë, pronën objekt kontrate.

NENI 6 PAGESA E QIRASË

6.1 Tarifat për dhënie në përdorim/qera të ketyre pasurive, të aplikohen sipas pika 8 e shtojcës nr 1 te Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 559, datë 29.7.2022 "Per percaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore"

6.2 "Qiramarrësi" detyrohet t'i paguajë "Qiradhënësit" detyrimin mujor të kontratës, në vlerën _____ lekë/muaj.

6.3 Pagesa e qirasë do të jetë mujore dhe do të bëhet brenda datës 10 të fillimit të çdo muaji, sipas faturës së lëshuar nga njësia që ka në administrim pasurinë shtetërore, me emërtimin "Pagesa e qirasë për muajin _____", nga subjekti " _____ ", për pasurinë " _____".

6.4 Para nënshkrimit të kontratës "Qiramarrësi" ka paguar garancinë e kontratës, e cila është e barabartë me vlerën e tre muajve të qirasë, sipas faturës së lëshuar nga "Qiradhënësi", e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të kësaj kontrate qiraje.

6.5 Pagesa e qirasë fillon me marrjen në dorëzim të objektit të kontratës, por jo më vonë se një muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

6.6 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete (gjoba dhe kamatëvonesa), "Qiramarrësi" do të likuideojë vlerat e krijuara në llogarinë e "Qiradhënësit", sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

NENI 7 PENALITETET

7.1 Në rastin kur "Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, sipas përcaktimeve, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të përcaktuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, "Qiradhënësi" zgjidh kontratën dhe gjobit "Qiramarrësin" me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.

7.2 Në rastin kur, "Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

NENI 8 ZGJIDHJA E KONTRATËS

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në këtë kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

- në marrëveshje midis palëve;
- kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore;
- kur "Qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në kontrate;
- kur "Qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në kontrate;
- kur prona nevojitet për interes publik;
- dh) kur prona kalon në procedurë privatizimi
- e) Kur "Qiramarrësi" shkel detyrimet e lejes se dhene nga institucionet perkatese Ministria e Infrastruktures dhe Energjise per afatin e ndertimit te impjantit fotovoltaik jo me shume se nje viti nga afati i lejes .

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari 30 ditë pas njoftimit me shkrim të "Qiradhënësit" për zgjidhjen e kontratës para afatit dhe nëse "Qiramarrësi" nuk ka reaguuar me shkrim.

NENI 9

PËRGJEGJËSITË E PALËVE

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga "Qiramarrësi", palët janë të detyruara të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuar, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.

9.3 Palët, "Qiramarrësi" dhe "Institucioni administrues dhe monitorues i kontratës së qirasë", janë të detyruar që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penalteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me "forcë madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si: tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për atë kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 "Qiramarrësi" përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të forcës madhore dhe mos kryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

NENI 10

DISPOZITA TË FUNDIT

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'u referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë planbiznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe procesverbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së qirasë.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

10.4 Në çdo rast të kalimit të mosmarrëveshjeve, të lindura mes palëve në juridiksion gjyqësor, autorizohet njësia administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

10.5 Kjo kontratë qiraje është e vlefshme deri në çastin, që prona publike e dhënë me qira privatizohet sipas akteve ligjore në fuqi.

NENI 11

TË TJERA

Kjo kontratë është formuluar në 3 kopje origjinale.

Pasi iu lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë.

QIRAMARRËSI

QIRADHËNËSI
BASHKIA POGRADEC
(Përfaqesuar nga Kryetari)

Ilir XHAKOLLI

REPUBLICA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHQIPTËRORE E KADASTRËS



ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri i Personit Juridik	Nr. Personal NIPT	Pjesa(-/-)
BASHKIA POGRADEC	K44802605R	1/1

Numri i Pasurisë	486		
Kodi Unik	1959007125		
Zona Kadastrale	1959		
Lloji i Pasurisë	KULLOTE		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 230788	Terrall: 0	Ndërtesë: 0
Vlera Aktuale e Pasurisë	1		
Adresa e Pasurisë	POGRADEC, POGRADEC, Rr.: HOMEZH		

DREJTORI
Zhuljen Manellari

Franci Beshiraj
Eugen Alinaj

Data e lëshimit: 30/08/2024
Manellari



Vlerësur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Pogradec
Data: 2024/08/30 14:13:58 +0200
K44802605R20240830141358L1014



REPUBLICA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS



KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 1959007125

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 1959 , Lloji i Pasurisë: KULLOTE , Nr. i Pasurisë: 486 , Sipërfaqja Totale 230788 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale K - 34 - 114 - (20-A) , Numri i Pemëve: 0 ,

Adresa e Pasurisë: Bashkia POGRADEC , Rruga HOMEZH , Ndërtesa Nr. _____ , SH/K 255 ,
Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillëstare 1 Lekë (Akti Nr. 2481 , Dt. 22/08/2024), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: BASHKIA POGRADEC , Nr. Identifikimi/NIPT K44802605R , Pjesa Takuese 1/1, Lloji i
Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia _____ , Rruga DESHMORET E POJSKES , Ndërtesa Nr. _____ , SH/K _____ ,
Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Vendim i KM (për kalim në pronësi të institucionit shtetëror/apo
vendimet e shpronësimit), Nr. 2481 , Datë: 22/08/2024

Regjistruar: Nr. 2481 , Datë: 30/08/2024

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____ , me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____ , Nr. _____ , Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____ , Datë: _____

REPublika e Shqipërisë
AGJENCIA SHITETËRORE E KADASTRËS



KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Drejtisë	Të Dhënat e Aktit			Adri i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtimi	Nr.	Datë		Emër Akti Mblidhës	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Adri i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtimi	Nr.	Datë		Emër Akti Mblidhës	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____, Emërtimi i Aktit: ____, Nr. ____, Datë: ____

Regjistruar: Nr. ____, Datë: ____

Përshkrimi: KO17 0 012B KULLOTË, PJESA TJETER E SIPERFAQES NDODHET NE PASURINE ME NR.811. DIFERENCE DOK-FAKT. 47, REF 2481 eshte ne udenisht

DREJTORI
ZhuJen Manellari



Viteor elektronik Akti nga Drejtoria
Verifika Regjistri
Data: 2024.08.30 14:14:22 +0200
K648C09d5A0E24063014141529A5HK

Franci Beshiraj
Eugen Alinj

Digitally signed by
Franci Beshiraj
Date: 2024.08.30
02:58:09 +0200

Digitally signed by
ZhuJen Manellari
Date: 2024.08.30
02:58:09 +0200

Digitally signed by
ZhuJen Manellari
Date: 2024.08.31
12:58:09 +0200



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE




ZONA KADASTRALE: 1959

KODI UNIK: 1959007125

NUMRI PASURISË: 486

INDEKSI HARTËS: K-34-114-(

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 2500

DREJTORI
Zhuljen Manellari

Eugen

Digitally signed by:
Eugen Alin
Date: 2024.08.30
09:18:02+0200

Alin

Zhuljen

Digitally signed by:
Zhuljen Manellari
Date: 2024.08.31
12:09:03+0200

Manellari



Vula e elektronike nga Drejtoria
Vendore Pograde
Date: 2024/08/30 17:18:36 +0200
K:44802908P02940830171828574014

SHPJEGUES

PARCELA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE



PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri i Personit Juridik	Nr. Personal NIPT	Pjesa(-/-)
BASHKIA POGRADEC	K44802605R	1/1

Numri i Pasurisë	811		
Kodi Unik	3665014023		
Zona Kadastrale	3665		
Lloji i Pasurisë	KULLOTJE		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 243875	Fruall: 0	Ndërtesë: 0
Vlera Aktuale e Pasurisë	1		
Adresa e Pasurisë			

DREJTORI
Zhuljen Manellari

Franci Beshiraj
Eugen Alinj

Drejtuesi i Departamentit
Data e lëshimit: 30/08/2024
Manellari



Vula eur e elektronikë nga Drejtoria
Vendore Pogradeç
Data: 2024.08.30 14:15:26 +0200
K44802605R2024083014151870X.1014



REPUBLICA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME



Kodi Unik 3665014023

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 3665 , Lloji i Pasurisë: KULLOTE , Nr. i Pasurisë: 811 , Sipërfaqja Totale 243875m2, (Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale K - 34 - 114 - (20-A) , Numri i Pemëve: 0 ,

Adresa e Pasurisë: Bashkia _____ , Rruga _____ , Ndërtesa Nr. _____ , SH/K. 255 , Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leka (Akti Nr. 2481 , Dt. 22/08/2024), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: BASHKIA POGRADEC , Nr. Identifikimi/NIPT K44802605R , Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia _____ , Rruga DESHMORET E POJSKES , Ndërtesa Nr. _____ , SH/K _____ , Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Vendim i KM (për kalim në pronësi të institucionit shtetëror/apo vendimet e shpronësimit), Nr. 2481 , Datë: 22/08/2024

Regjistruar: Nr. 2481 , Datë: 30/08/2024

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____ , me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____ , Nr. _____ , Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____ , Datë: _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME



C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtimi	Nr.	Data		Emër Akti Mbikëmbës	Nr. Identifikimi/NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkesë	
			Emërtimi	Nr.	Data		Emër Akti Mbikëmbës	Nr. Identifikimi/NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: Sipas urdherit të ASHKPogradec u ndryshua nr i vot, faqes sipas urdherit NR 247 dt 30.08.2024

DREJTORI
Zhuljen Manellari

Franci Beshiraj
Eugen Alinj

Digitally signed by Eugen Alinj
Date: 2024.08.30 09:19:58 +0200
Digitally signed by Zhuljen Manellari
Date: 2024.08.31 12:43:23 +0200



Vlerësuar elektronikisht nga Drejtoria
Vardara Pogradec
Data: 2024/08/30 14:15:53 +02'00'
K44862656R2024083014154655ASHK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 3665

KODI UNIK: 3665014023

NUMRI PASURISË: 811

INDEKSI HARTËS: K - 34 - 114 - (

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 2500

DREJTORI
Zhuqjen Manellari

Eugen
Alij

Digitally signed by:
Eugen Alij
Date: 2024.08.30
17:11:57 +0200

Zhuqjen
Manellari

Digitally signed by:
Zhuqjen Manellari
Date: 2024.08.31
17:46:53 +0200



Vijesur elektronikisht nga Drejtoria
Verifikim Pogrambe
Date: 2024.08.30 17:11:57 +0200
K44802805R20240830171750354014

SHPJEGUES

PARCELA